



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/98  
Datë: 23.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shtator 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për Zgjatjen e Masave Emergjente në Furnizimin e Energjisë**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, zgjatjen e masave emergjente në furnizimin e energjisë, me qëllim të normalizimit të plotë të gjendjes në nivel të shtrirjes dhe kohëzgjatjes së nevojshme, edhe prej tridhjetë (30) ditësh.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Nr. 01/91 të datës 31.07.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Nr. prot.1800/3 të datës 09.08.2022.
3. Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë